

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e praktikantes Besjana Çollaku procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit J. D. nga fshati M. Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP.nr.2122-7/2016 të datës 28.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit Musli Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokat P. K. nga Gjakova, me datë 01.11.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

J. D. nga i ati P. dhe e ëma D. e lindur N., i lindur më datë *data e lindjes...* në Gjakovë, tani me banim në fshatin M. Komuna e Gjakovës, ka të kryer shkollën fillore, bujk, i pa martuar, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datën 19.07.2016 rreth orës 14:30 minuta, në fshatin P. Komuna e Prizrenit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, me paraqitje të rreme të fakteve, e mashtron dhe e vë në lajthim të dëmtuarin F. T., vepron në dëm të pasurisë së tij, pasi që numrin e telefonit e kishte siguruar përmes rrjetit social “Merr Jep”, ku i dëmtuari kishte bërë publikimin për shitje të automjetit, pas bisedës telefonike me të dëmtuarin ka shprehur interesim për blerje të automjetit të markës “WV Golf IV”, me tagra të regjistrit gjerman *numri i targës...*, janë takuar dhe pas shikimit të automjetit nga i dëmtuari kërkon ta provoj, të cilin e kishte drejtuar i akuzuari dhe pas vozitjes afërsisht 2 km, ishin kthyer në vendin nga ishin nisë, kishin dalë nga automjeti dhe deri sa motori kishte qenë duke punuar edhe një here e shikon atë, shfrytëzon momentin e duhur duke e mbajtur në lajthim të dëmtuarin, ulet në ulësen e vozitësit ku nga i dëmtuari kërkon librezën CRA dhe librin e servisit, në momentin kur i dëmtuari i afrohet që t’ia tregoi, i njëjti shtynë atë e largon nga dera e mjetit, e rritë shpejtësinë vrullshëm largohet nga aty, shkon në fshatin R. Komuna e Pejës ku në treg e shet një personi të panjohur për shumën e të hollave prej 800 €, me ç’rast të dëmtuarit i shkakton dëm material.

Kësodore ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43, 46, 49, 50, 51, 73, 83 dhe nenit 335 par.1 të KPK i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- Në shumë prej 900 € (nëntëqind euro), në të cilin dënim do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.08.2016 e gjerë më datën 29.09.2016, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim do të hiqen nga 20 € për një ditë në burg.

DËNIM ME KUSHT

- Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale.

I dëmtuari F. T. nga fshati P. Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Mbikëqyrjen e dënimin me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Gjakovë, në pajtim me nenin 159 par.1 të LESP.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP.nr.2122-7/2016 të datës 28.10.2016, kundër të akuzuarit J. D. nga fshati M. Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 335 par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas kësaj deklaroi se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat materiale.

Në seancën e datës 01.11.2017 mbrojtësi i të akuzuarit avokat P. K. ka deklaruar se pas konsultimit me të akuzuarin, i njëjti ka shprehur vullnetin e lirë që ta pranojë fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet. Po ashtu ka theksuar se i akuzuari në procedurën paraprake, para zyrtarëve të policisë por edhe gjatë seancës fillestare ka pranuar fajësinë, duke konsideruar se është në përputhje me dispozitat ligjore, andaj nga gjykata kërkon pranimi i fajësisë të aprovohet.

Gjykata në seancën fillestare ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 19.07.2016 rreth orës 14:30 minuta, i akuzuari J. D. me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, me paraqitje të rreme e mashtron dhe e vë në lajthim të dëmtuarin F. T., i cili pas bisedës telefonike ka takuar të dëmtuarin me qëllim të arritjes së marrëveshjes për blerjen e veturës së markës “WV Golf IV” me tagra të regjistrit gjerman *numri i targës...*. I akuzuari pasi që provon automjetin nga i dëmtuari kërkon librezën e qarkullimit dhe librin e servisit, e në momentin kur i dëmtuari afrohet për t’ia treguar dokumentet, i akuzuari e shtynë atë duke e larguar nga dera e veturës dhe me shpejtësi largohet nga aty. Më pas në fshatin R. Komuna e Pejës veturën në fjalë i shet personit të panjohur në shumën prej 800 €, me ç’rast të dëmtuarit i shkakton dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka

administruar provat, pasi që nuk ka ekzistuar ndonjë provë e papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza, me ç'rast i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale e përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, është i gjendjes së dobët ekonomike gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e kësajllatilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të KPPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të KPPK.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2346/2016 të datës 01.11.2017

Procesmbajtësja
Besjana Çollaku

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.